

VENDIM
Nr. 608, datë 11.9.2019

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I
PROJEKTIT “ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE”, LUSHNJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave publike”, Lushnjë.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Lushnjë.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 16 503 358.20 (gjashtëmbëdhjetë milionë e pesëqind e tre mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë pikë njëzet) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 16 503 358.20 (gjashtëmbëdhjetë milionë e pesëqind e tre mijë e treqind e pesëdhjetë e tetë pikë njëzet) lekësh, të përballohet nga buxheti i Bashkisë Lushnjë.
 5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.
 6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.
 7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Lushnjë.
 8. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Lushnjë, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit, Bashkia Lushnjë.
 9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit, Bashkia Lushnjë, për pasuritë e shpronësuara.
 10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Lushnjë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA ME VLERËSIMIN PARAPRAK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTI "ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE, LUSHNJË"

Nr.	Emër Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Rrethi	Sip. e ndërtimit (m ²)	Sip. e truallit (m ²)	Çmimi i ndërtimit (l/m ²)	Çmimi i truallit (l/m ²)	Vlera e ndërtimit (lekë)	Vlera e truallit (lekë)	Vlera totale (lekë)	Shënime
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1	Xhevdet Korreshi	ZK. 8571	7/104/15	Lushnjë	—	283.3	—	9,709	—	2,750,559.70	2,750,559.70	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Lushnje me shkresën nr. 8424/1 prot., datë 14.9.2018. Pasuri e llojit “Truall”.
2	Bashkëpronarët Lufta	ZK. 8571	7/104/16	Lushnjë	—	283.3	—	9,709	—	2,750,559.70	2,750,559.70	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Lushnje me shkresën nr. 8424/1prot., datë 14.9.2018. Pasuri e llojit “Truall”.
3	Bashkëpronarët Habili dhe Çela	ZK. 8571	7/104/17	Lushnjë	—	283.3	—	9,709	—	2,750,559.70	2,750,559.70	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Lushnje me shkresën nr. 8424/1 prot., datë 14.9.2018. Pasuri e llojit “Truall”.
4	Hekuran Korreshi	ZK. 8571	7/104/18	Lushnjë	—	283.3	—	9,709	—	2,750,559.70	2,750,559.70	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Lushnje me shkresën nr. 8424/1 prot., datë 14.9.2018. Pasuri e llojit “Truall”.
5	Hasan Korreshi	ZK. 8571	7/104/19	Lushnjë	—	283.3	—	9,709	—	2,750,559.70	2,750,559.70	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Lushnje me shkresën nr. 8424/1 prot., datë 14.9.2018. Pasuri e llojit “Truall”.
6	Petrit Korreshi	ZK. 8571	7/104/20	Lushnjë	—	283.3	—	9,709	—	2,750,559.70	2,750,559.70	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Lushnje me shkresën nr. 8424/1 prot., datë 14.9.2018. Pasuri e llojit “Truall”.
VLERA TOTALE E SHPRONËSIMIT											16,503,358.20	